



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA HIMARË
KRYETARI

Nr. 5932 prot.

Himarë, më 29.07.2025

URDHËR

Nr. 428 Datë 29.07/2025
PËR

**“KUFIZIMET NË QARKULLIMIN E MJETEVE RRUGORE TË RËNDA TË
TRANSPORTIT TË PERSONAVE GJATË SEZONIT TURISTIK”**

Mbështetur në pikën 2 të nenit 113 të Kushtetutës së Shqipërisë, në ligjin Nr.44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative”, ligjin Nr. 139/ 2015, “Për vetëqeverisjen vendore”, ligjin 10431/2011 “Për mbrojtjen e mjedisit”, ligjin 8378/1998 “Kodi rrugor i Republikë së Shqipërisë”, ligjin 90/2012 “Për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore”, ligjin 93/2015 “Për turizmin”, VKM-së Nr.153/2000 “Rregullorja për zbatimin e Kodit Rrugor”, Udhëzimit të përbashkët Nr.7967/2018 “Mbi kufizimet në qarkullimin e mjeteve të rënda për transportin e mallrave përgjatë sezonit turistik” dhe VKB Himarë Nr.7 datë 11.02.2025 “ Për miratimin e planit të punës, për menaxhimin e sukseshëm të sezonit turistik 2025 dhe planit të veprimtimit përkatës”. Me qëllim sigurimin e një sezoni të qëndrueshëm, krijimin e një mjedisi miqësor për pushuesit vendas dhe të huaj, duke eliminuar pengesat dhe bllokimet si rrjedhojë e qarkullimit të rënduar gjatë sezonit turistik:

URDHËROJ:

- 1- Të ndalohet për periudhën 01/08/2025 deri më 15/09/2025, qarkullimi i mjeteve rrugore të rënda për transportin e personave mbi 3.5 tonë (fugonë, autobusa,) në segmentin e Unazës së Vogël të qytetit Himarë.
- 2- Të devijohet qarkullimi i mjeteve rrugore të rënda për transportin e mallrave/personave mbi 3.5 tonë (fugonë, autobusa) në segmentin e unazës së madhe të qytetit Himarë.
- 3- Subjektet e licensuara për transportin e personave të marrin masa njoftimin e pikave të ndalimit.
- 4- Për zbatimin e këtij urdhëri ngarkohet Drejtoria e Policisë Bashkiake Himarë, Drejtoria e Mbrojtjes së Territorit dhe Ndërmarrja e Shërbimeve Publike Himarë.
- 5- Përfshihen nga parashikimet e këtij urdhri subjektet e licensuara dhe me vendqëndrime të miratura në qytetin e Himarë.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI

Vangjel Tavo

